



MBJELLJET E DYTA NË SERA

Prodhimtaria e perimeve në sera, paraqet formën më intensive të prodhimit në bujqësi. Një ndër parakushtet më të rëndësishme për arritjen e rendimenteve të larta, në këtë mënyrë të prodhimit është njohja e teknologjisë së kultivimit të perimeve, llojet e serave dhe nevojat e tregjeve për produkt.

Statistikisht në Shqipëri operojnë rreth 2100 ha sera, të cilat kryesisht janë të shtrira në rajonin e Lushnjës, Divjakës, Beratit, Fierit dhe Elbasanit. Njësia Administrative Kutalli-Berat është një tjetër potencial në zhvillimin e serave me afërsisht 500 ha sera diellore.

Gjatë vitit 2022, eksportet e prodhimeve bujqësore arritën vlerën më të lartë rreth 480 milion Euro. Statistikisht, produkti me volum më të lartë rezulton domatja e serave, e cila ka edhe kërkesën më të lartë për eksport.



KUSH DO ISHTE NJË PLANIFIKIM SMART PËR FERMERËT E SERAVE?

Nisur nga situata e paqëndrueshme atmosferike, intensiteti shumë i lartë i reshjeve gjatë periudhës 15 Maj – 15 Qershor 2023, rezultoi në një dëmtim të vlerësuar deri në masën 25-30% të prodhimeve të fushës (domate, trangull, patllixhan etj.), humbje kjo e cila mund të rezultojë në një mungesë prodhimi në tregun vendas si dhe atë eksport.

Duke vlerësuar dëmin dhe uljen e prodhimit të perimeve të fushës nga njëra anë, dhe kërkesën e tregut vendas (shtuar edhe sezoni turistik) apo atij për eksport, parashikohet që çmimi i perimeve të serës mund të rezultojë me një rritje prej 30-40% gjatë periudhës Gusht - Shtator 2023.

Prandaj, bazuar në analizat e kryera nga ekspertët e fushës, mbjellja e serave me perime, kryesisht domate, dhe dalja në treg gjatë muajit Gusht, parashikohet të rezultojë me një përthithje dhe vlerë financiare të lartë për fermerët.



“PËRFITONI NGA MUNGESA APO SITUATAT E PAFAVORSHME ATMOSFERIKE PËR TË PRODHUAR SMART DHE AKSESUAR NEVOJËN E TREGJEVE”

“NOA FINANCON, NOA KËSHILLON”

NOA është lider i financimit të sipërmarrjeve të vogla, fermerëve dhe familjeve shqiptare. Një nga synimet e NOA-s është të mbështesë të gjithë fermerët në bujqësi dhe blegtori që të zhvillojnë biznesin e tyre nëpërmjet financimit, këshillimit financiar dhe përthithjes së granteve në agrobiznes.